BANKA E SHQIPËRISË

Revista Ekonomike

6M1-2020

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

** Pikëpamjet e shprehura në këto artikuj janë të autorëve, punonjës të Bankës së Shqipërisë, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të institucionit.*

P Ë R M B A J T A

COVID19: A PREKEN KURSIMET NË KOHË PANDEMIE? NJË VËSHTRIM MBI SJELLJEN E KURSIMEVE NË RAJONIN E EQJL-SË *5*
Olta Manjani, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

EVIDENCA MIKROEKONOMIKE MBI SJELLJEN ÇMIM-PËRCAKTUESE NË EKONOMINË SHQIPTARE *13*
Ola Çami, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

BLOCKCHAIN DHE BANKA E SHQIPËRISË *29*
Margerita Topalli, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

COVID19: A PREKEN KURSIMET NË KOHË PANDEMIE? NJË VËSHTRIM MBI SJELLJEN E KURSIMEVE NË RAJONIN E EQJL-SË

Olta Manjani, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

1. HYRJE

Përhapja me ritme të shpejta e pandemisë Covid-19 dhe humbjet në jetë njerëzish që ajo ka shkaktuar, si dhe masat e distancimit social që janë ndërmarrë për kontrollin e saj janë shndërruar në burimin më të madh të pasigurisë për të ardhmen në aspektin shëndetësor, ekonomiko-financiar apo social, qoftë në terma afatshkurtër, apo edhe në terma afatgjatë. Ndikimi në aktivitetin ekonomik dhe efektet zinxhir të saj kanë rezultuar në qendër të analizave të kohëve të fundit. Të dhënat e aktivitetit ekonomik për tremujorin e parë të vitit, por edhe parashikimet për pjesën e mbetur të vitit, tregojnë për recesion në shumë vende. Rënia e kërkesës agregate, veçanërisht gjatë periudhave të izolimit social, por edhe në vijim, shoqëruar me tkurrjen e prodhimit, humbjen e vendeve të punës dhe rritjen e pasigurisë janë disa nga faktorët që kanë ndikuar negativisht aktivitetin ekonomik. Ato pritet të vijojnë të mbeten të tilla deri në fund të vitit dhe/ose më tej.

Ky material synon të analizojë sjelljen e kursimeve të individëve/ ekonomive familjare në kohë pandemie. Kursimet në ekonomi janë funksion i të ardhurave të disponueshme, prirjes për konsum dhe sjelljes së ekonomive familjare në lidhje me shpërndarjen e njëtrajtshme të konsumit në kohë, si dhe e perceptimit të (pa)sigurisë së tyre për zhvillimet në të ardhmen. Monitorimi i këtij treguesi mund t'i shërbejë politikëbërësve për të plotësuar më mirë panoramën e gjendjes financiare të individëve dhe rrjedhimisht për adresimin e sfidave me të cilat mund të përballen. Materiali vijon me një rishikim të literaturës mbi pasojat ekonomike dhe financiare të pandemisë Covid-19 dhe pandemive të ngjashme, me shembuj sporadikë mbi ecurinë e kursimeve në sistemin bankar. Ai vijon më tej me një analizë të efekteve të mundshme të pandemisë Covid-19 mbi kursimet në rajonin e EQJL-së dhe përfundon me komentet përmbyllëse në fund të materialit.

2. RISHIKIM I LITERATURËS

Natyra dhe kohëzgjatja e pandemisë Covid-19 është ende e panjohur plotësisht. Megjithatë, në literaturën ekonomike gjenden analiza mbi kostot dhe pasojat ekonomike të epidemive me natyrë infektive. Në historinë moderne, ato fillojnë me Gripin Spanjoll (1918-1920) në fillim-shekullin e XX-të, dhe vijojnë me epidemi më të vogla në shekullin XXI si epidemia e SARS në vitin 2002, H1N1 në vitin 2009 dhe Ebola në vitin 2014 (Stephany et al.,2020). Studimet mbi pasojat e epidemisë së SARS në ekonomi tregojnë për reduktim të ndjeshëm të konsumit të mallrave dhe shërbimeve, rritje të kostove operative

të biznesit si dhe rritje të primeve të rrezikut për vende të ndryshme (McKibbin dhe Fernando, 2020). Goodell (2020) sjell një përmbledhje të artikujve që analizojnë pasojat ekonomike dhe sociale të Covid-19, si dhe të pandemive dhe epidemive të tjera me përmasa të mëdha. Ato grupohen sipas ndikimit të tyre në ekonomi, në sektorin bankar dhe atë të sigurimeve, si dhe në sektorin publik. Baldwin dhe Mauro (2020) sjellin gjithashtu një përmbledhje artikujsh mbi implikimet ekonomike potenciale të Covid-19, bazuar kryesisht në të dhëna deskriptive, opinione dhe simulime. Ato variojnë nga ndikimi i pandemisë Covid-19 në tregti, në tregjet e punës dhe ato financiare, deri në masat makroekonomike dhe monetare të ndërmarra për zbutjen e ndikimit negativ të saj. Në përgjithësi, opinionet e ekonomistëve, bashkërenduar me të dhënat e tremujorit të parë dhe të dytë të vitit, tregojnë se pasojat dhe kostot e pandemisë Covid-19 janë të paprecedenta në historikun e epidemive të kohëve të fundit. Për shembull, sipas Huang et al. (CEPR Press, 2020), në Kinë, vendi nga ku pati zanafillën pandemia, sektorët e shërbimeve dhe industrisë prodhuese rezultojnë të jenë më të goditurit nga kriza e shkaktuar nga Covid-19. Ramelli dhe Wagner përdorin një kombinim të të dhënave nga motori i kërkimit Google për të matur vëmendjen kushtuar pandemisë Covid-19 me të dhëna nga tregjet e kapitalit, për të kapur ndikimin në ekonomi sipas sektorëve. Sipas kësaj analize, sektorët e energjisë, transportit dhe tregtisë me pakicë kanë pësuar humbjet më të mëdha në ShBA dhe në Kinë, ndërsa sektori i shëndetësisë ka përfituar në mënyrë të konsiderueshme.

Një grup tjetër materialesh përqendrohen në pasojat e Covid-19 në treguesit financiarë. McKibbin dhe Fernando (2020) ndërtojnë shtatë skenarë të ndryshëm bazuar mbi një model hibrid DSGE/CGE me 6 sektorë për 24 vende, duke faktorizuar probabilitetin e evoluimit të pandemisë dhe ndikimin e saj në tregjet financiare dhe treguesit makroekonomikë në nivel global. Rezultatet tregojnë se edhe në skenarët më të përmbajtur, pasojat financiare dhe ekonomike janë të mëdha në terma të tkurrjes së PBB-së, si pasojë e tkurrjes së investimeve, konsumit privat dhe bilancit tregtar, si edhe të pasojave në tregjet e kapitalit etj. Stephany et al. (2020) ndërtojnë disa indekse të matjes në kohë reale të rreziqeve nga Covid-19, duke përdorur databazën e të dhënave të kompanive të regjistruara në bursë në ShBA. Gjetjet e tyre sugjerojnë se bizneset u paraprijnë këtyre rreziqeve – nëpërmjet matjeve të kryera nga këta tregues të ndjesisë së riskut – para se ato të reflektohen në tregjet e kapitalit. Lagoarde-Segot dhe Leoni (2013) ndërtojnë një model teorik për vendet në zhvillim, i cili tregon se rreziku i dobësimit të sistemit bankar nga tërheqja e depozitave në kohë epidemie rritet proporcionalisht me shkallën e përhapjes së epidemisë në vendet në zhvillim, si dhe shoqërohet me rritje proporcionale të rezervave të bankave. Megjithatë, autorët theksojnë se ky është një model teorik dhe pavarësisht episodeve të tërheqjeve të depozitave në kohë epidemie, asnjë krizë bankare nuk është materializuar në vendet e marra në studim. Skoufias (2003), në një përmbledhje të 12 studimeve mbi strategjitë e përballimit nga individët të pasojave të krizave, epidemive apo goditjeve të tjera të ngjashme në përmasa të mëdha, ndër të tjera, konkludon se kreditimi për shtresat e varfra nga institucionet e mikrokredisë, apo edhe nga bankat, reduktohet pasi të gjithë anëtarët e grupit preken nga një goditje e tillë.

Më të pakta janë analizat që kanë në fokus sjelljen e kursimeve të agjentëve ekonomikë gjatë pandemisë Covid-19, apo edhe në periudha të tjera pandemish të ngjashme. Në këtë linjë, Leoni (2013) analizon sjelljen e depozitave në sistemin bankar në vendet në zhvillim. Studimi evidenton se përhapja e epidemisë është e lidhur me rënie të kursimeve të individëve në sistemin bankar. Kjo ecuri shpjegohet me nevojën e përdorimit të kursimeve për të paguar për trajtimet shëndetësore. Ndërkohë, të dhënat më të fundit tregojnë se me përhapjen e pandemisë Covid-19 individët kanë rritur kursimet e tyre – depozitat në sistemin bankar dhe mbajtjet në *cash* apo forma të tjera investimi – shoqëruar paralelisht me uljen e shpenzimeve konsumatore[1], fakt ky i cili shpjegohet me pasigurinë e agjentëve ekonomikë për zhvillimet në të ardhmen. Paralelisht me të, bazuar në simulimet e McKibbin dhe Fernando (2020) me modelin DSGE/CGE dhe goditjeve të supozuara në këto simulime, vërehet zhvendosje e fondeve të agjentëve ekonomikë nga tregjet e kapitalit – për arsye të rritjes së rrezikut dhe pritjeve për reduktim të fitimeve si pasojë e rënies ekonomike – pjesërisht në letra me vlerë, pjesërisht në *cash* dhe pjesërisht në mjete jorezidente në varësi se cilat tregje janë prekur më shumë.

3. ECURIA E KURSIMEVE GJATË PANDEMISË COVID-19 NË RAJONIN E EQJL-SË

Kursimet e individëve përfshijnë të gjitha mjetet monetare në formën e depozitave, parasë së mbajtur në formë likuide ose investimeve në letra me vlerë të qeverisë, fonde pensioni, aksione të kompanive apo instrumente të tjera financiarë. Megjithatë, tregjet financiare në disa prej vendeve të Ballkanit janë në fazat e hershme të zhvillimit dhe investimet e individëve në instrumente të tilla janë ende të papërfillshme. Edhe në vende të zhvilluara si ato në rajonin e Eurozonës, peshën më të madhe në portofolin e investimeve të individëve në instrumente financiar e mbajnë depozitat në sistemin bankar dhe mbajtjet në formë *cash*[2]. Në këtë kontekst, kursimet e individëve në disa prej këtyre vendeve janë përafruar me shumën e depozitave të individëve në sistemin bankar dhe mjetet monetare likuide të mbajtura në formën *cash*. Në disa raste ato përfshijnë edhe investimet në letra me vlerë të qeverisë. Ekuacionet në vijim paraqesin supozimet kryesore për përafrimin e kursimeve të individëve:

$$K_i = D_i + PJB_i + LMV_i \quad \text{(i)}$$

ku, K_i përfaqëson totalin e kursimeve, PJB_i stokun e mbajtjeve *cash* të individëve dhe LMV_i stokun e investimeve në letra me vlerë të qeverisë. Stoku i parasë jashtë bankave të individëve llogaritet si raport ndaj totalit të parasë jashtë bankave në lekë[3]:

[1] *Për vendet të cilat kanë të dhëna të disponueshme për tremujorin e parë deri në momentin e publikimit: https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/-/DDN-20200806-2?inheritRedirect=true&redirect=/eurostat/web/main/home*

[2] *https://sdw.ecb.europa.eu/reports.do?node=1000004900*

[3] *Në këtë llogaritje nuk përfshihet stoku i parasë jashtë bankave në monedhë të huaj. Ky stok nuk mund të matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërsa për llogaritjen e tij në mënyrë të tërthortë kërkohen supozime shumë të forta.*

$$PJB_i = \alpha_i * PJB_t \quad \text{(ii)}$$

α_i përfaqëson raportin e parasë jashtë bankave që mbajnë individët vs. agjentëve të tjerë ekonomikë. Për llogaritjen e tij është supozuar mbajtja e të njëjtës peshë me atë të depozitave të individëve në totalin e depozitave në sistemin bankar:

$$\alpha_i = D_i/D_t \quad \text{(iii)}$$

Të dhënat e kursimeve të individëve në shumicën e vendeve të rajonit shfaqen me rritje në gjashtëmujorin e parë të vitit, veçanërisht në tremujorin e dytë, ku përhapja dhe efektet e pandemisë kanë qenë më të përqendruara. Kjo ecuri është në linjë me raportimet e ecurisë së tyre edhe në vendet e BE-së, ku bëjnë pjesë të gjitha vendet e Evropës Qendrore, në grafikun majtas. Sjellje e ngjashme vërehet në vendet e Ballkanit, të cilat shfaqin një prirje rritëse në normat vjetore të kursimeve të individëve, veçanërisht në tremujorin e dytë.

Grafik 1. Ndryshimet vjetore të kursimeve në vendet e rajonit të EQJL-së



*Të dhënat e kursimeve të individëve për Shqipërinë, Kroacinë, Rumaninë dhe Hungarinë përfshijnë depozitat në sistemin bankar, mbajtjet në cash dhe investimet në letra me vlerë; pjesa tjetër e vendeve përfshin depozitat e individëve dhe mbajtjet në cash.

Burimi: Bankat qendrore përkatëse; llogaritje të autorit.

Të dhënat e kursimeve në vendet e BE-së për tremujorin e parë të vitit 2020 tregojnë për rritjen më të madhe të tyre, në 20 vitet e fundit, me 3.5 pp mesatarisht në terma vjetorë. Rritja e kursimeve të individëve gjatë kësaj periudhe ka qenë e pranishme në të gjitha vendet e BE-së[4]. Bazuar në të dhënat dhe analizën e Eurostat, arsyeja kryesore e kësaj ecurie është rënia e shpenzimeve konsumatore në terma vjetorë për të njëjtën periudhë (-1.7%), përkundrejt normave të rritjes së tyre me mbi 2% në periudhat paraardhëse. Sjellje e ngjashme vërehet edhe në rajonin e EQJL-së, siç shihet dhe në bllokun e mëposhtëm të grafikëve. Në atë majtas paraqiten normat vjetore të konsumit për vendet jo-anëtare të BE-së, ndërsa në grafikun djathtas përfshihen vendet e rajonit, anëtare të BE. Duke përjashtuar Serbinë, të gjitha vendet e rajonit të EQJL-së kanë shënuar ulje të shpenzimeve konsumatore në tremujorin e parë të vitit, e cila shpjegon rritjen e kursimeve të tyre gjatë të njëjtës periudhë.

[4] *https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Impact_of_Covid-19_crisis_on_non-financial_corporation_and_household_accounts*

Grafik 2. Ndryshime vjetore të shpenzimeve konsumatore të individëve



Burimi: Eurostat.

Për të kuptuar nëse rritja e kursimeve është një tendencë afatshkurtër apo pritet të vijojë në të ardhmen, në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat nga vrojtimi i besimit konsumator mbi pritjet e individëve për kursimet e tyre në 12 muajt e ardhshëm. Pritjet për kursim përfaqësojnë balanca neto të përgjigjeve të tyre të paraqitura si diferencë nga mesatarja historike. Individët në vendet e Ballkanit shfaqen relativisht më pesimistë për kursimet në të ardhmen krahasuar me periudhën aktuale. Në vende si Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Serbia, pritjet e tyre për kursim vijojnë të shfaqen poshtë mesatares së tyre historike. Ndërkohë, të gjitha vendet e BE-së janë shprehur për rritje të kursimeve në të ardhmen, dhe në vendet e Evropës Qendrore kjo prirje pritet të intensifikohet në 12 muajt e ardhshëm. Këto rezultate mund të shpjegohen me pritjet e individëve për kohëzgjatjen e krizës. Në vendet e Ballkanit që nuk janë pjesë e BE-së dhe ku niveli i të ardhurave është më i ulët, pritjet për ecurinë ekonomike dhe të të ardhurave, mund të kenë ndikuar pritjet e individëve për kursime në kahun rënës gjatë 12 muajve të ardhshëm.

Grafik 3. Pritjet për kursim të individëve në rajonin e EQJL-së (diferenca e balancave neto nga mesatarja historike)



Burimi: Vrojtimi i besimit konsumator, Banka e Shqipërisë dhe Komisioni Evropian.

4. KOMENTE PËRMBYLLËSE

Studimi i sjelljes së kursimeve të individëve/ ekonomive familjare në periudha epidemish/pandemish është i rëndësishëm.

Treguesit mbi kursimet në Shqipëri dhe në vendet e rajonit tregojnë për rritje të kursimeve të individëve në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit. Sjellje e ngjashme e individëve evidentohet gjithashtu në të gjitha vendet e BE-së. Kjo ecuri pasqyron rënien e konsumit, bazuar në të dhënat e shpenzimeve konsumatore për tremujorin e parë të vitit, si dhe rritjen e pasigurive për të ardhmen.

Sa i përket zhvillimeve në të ardhmen, të dhënat e vrojtimeve mbi pritjet e individëve për kursim, evidentojnë një prirje në ngadalësim të tyre për 12 muajt e ardhshëm, në disa prej vendeve të Ballkanit. Me rënien e burimeve të të ardhurave për periudha kohore të zgjatura, individët priren të ruajnë një nivel të qëndrueshëm në kohë të konsumit të mallrave dhe shërbimeve bazë, duke përdorur kursimet për përballimin e nevojave të tyre. Kjo është në linjë me gjetjet e Leoni (2011), ku përhapja e shpejtë e epidemive në vendet në zhvillim ka një lidhje shkakësore me rënien e depozitave në sistemin bankar. Megjithatë, literatura sugjeron gjithashtu se në kohëra krizash ekonomike, fatkeqësish natyrore apo epidemish/pandemish, mund të priten ndryshime strukturore në sjelljen e ekonomive familjare. Efekti i pasigurisë për të ardhmen mund të mbizotërojë atë të rënies së të ardhurave, ku individët priren më shumë drejt kursimit dhe më pak drejt konsumit, përgjatë periudhave të krizave, por edhe në kohë normale.

Për këtë arsye, monitorimi i balancës së këtyre faktorëve nga politikëbërësit është me rëndësi për të pasuruar me informacion shtesë tablonë e përgjithshme të zhvillimeve dhe tendencën e tyre afatgjatë.

REFERENCA

Baldwin Richard and Beatrice Weder Mauro, 2020. Economics in the Time of COVID-19. CEPR Press.

Baldwin Richard and Beatrice Weder Mauro, 2020. Mitigating the COVID Economic Crisis: Act Fast and Do Whatever It Takes. CEPR Press.

Goodell, John W., April 2020. COVID-19 and finance: Agendas for future research. Finance Research Letters.

Lagoarde-Segot, Thomas, Leoni, Patrick L, 2013. Pandemics of the poor and banking stability. Journal of Banking and Finance 37 (11).

Leoni, Patrick L.. HIV/AIDS and Banking Stability in Developing Countries. 2011. The Bulletin of Economic Research.

McKibbin, Warwick and Roshen Fernando, 2020. The Global Macroeconomic Impacts of COVID-19:
Seven Scenarios. Centre for Applied Macroeconomic Analysis

Ramelli S, Wagner A. What the stock market tells us about the consequences of COVID-19. In: Mitigating the COVID.

Skoufias, E., 2003. Economic crises and natural disasters: Coping strategies and policy implications. Vol. 31, No. 7, pp. 1087–1102.

Stephany, Fabian, Niklas Stoehr, Philipp Darius, Leonie Neuhwuser, Ole Teutloff, Fabian Braesemann. Prill 2020. The CoRisk-Index: A data-mining approach to identify industry-specific risk assessments related to COVID-19 in real-time. Working paper V1.3 - 27th April 2020. http://oxford.berlin/CoRisk

EVIDENCA MIKROEKONOMIKE MBI SJELLJEN ÇMIM-PËRCAKTUESE NË EKONOMINË SHQIPTARE

Ola Çami, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

1. HYRJE

Megjithëse teoria klasike parashikon përshtatjen e vazhdueshme dhe të plotë të çmimeve në përgjigje të ndryshimeve të kërkesës dhe ofertës, ngurtësia e çmimeve ose prirja e çmimeve për të mos ndryshuar, është dokumentuar vazhdimisht për një sërë tregjesh (Carlton, 1986). Firmat nuk i axhustojnë çmimet e tyre në përgjigje të çdo goditjeje që pëson ekonomia. Bazuar në teorinë "E Re Kejnsianiste", çmimet përcaktohen jo vetëm nga situata aktuale ekonomike, por edhe nga pritjet që kanë agjentët për të ardhmen. Në këtë kontekst, çmimet që ndryshojnë më rrallë (çmimet e ngurta) përmbajnë më tepër informacion mbi pritjet për të ardhmen sesa çmimet të cilat ndryshojnë më shpesh (çmimet fleksibël) (Bryan dhe Meyer, 2010).

Heterogjeniteti mes firmave në lidhje me nivelin e ngurtësisë ose fleksibilitetit të çmimeve është gjithashtu i dokumentuar në kontekstin e sektorëve të ekonomisë apo të mirave/ shërbimeve të ndryshme (Hannan dhe Berger, 1991; Kashyap, 1995). Studimet kryesisht pajtohen se heterogjeniteti ekziston dhe është veçanërisht prezent ndërmjet grupit të mallrave dhe atij të shërbimeve: çmimet e shërbimeve janë ndjeshëm më të ngurta sesa ato të mallrave.

Një literaturë e gjerë i është dedikuar gjithashtu analizës së implikimeve të ngurtësive nominale të ekonomisë në nivelin e inflacionit dhe prodhimit agregat. Kjo literaturë gjen se këto ngurtësi dhe reagimi i ekonomisë ndaj një sërë zhurmash potenciale në të ardhmen kanë implikime mbi sjelljen e politikës monetare. Në teorinë makroekonomike moderne, ngurtësia e çmimeve është një burim i rëndësishëm i jo-neutralitetit të parasë në afatshkurtër dhe ka implikime në dinamikat e inflacionit. Veçanërisht, shkalla e ngurtësisë nominale është një nga përcaktuesit e pjerrësisë të kurbës së Filipsit të "Re Kejnsianiste", e cila është e ndërtuar mbi baza mikroekonomike dhe është e përdorur gjerësisht në analizat makroekonomike të bankave qendrore. Për rrjedhojë, për një bankë qendrore e cila shënjestron inflacionin është e dobishme zotërimi i informacionit mbi sjelljen, pritjet dhe heterogjenitetin e treguesit të inflacionit.

Në këtë kontekst, ky material ka për qëllim të analizojë frekuencën ose shpeshtësinë e ndryshimit të çmimeve në Shqipëri, duke përdorur çmimet në nivel mikro të cilat përmban indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK) dhe të hulumtojë karakteristikat e sjelljes çmim-përcaktuese në ekonominë shqiptare. Pjesa më e madhe e studimeve ekzistuese me baza mikroekonomike fokusohen në tregje ose produkte specifike, për shembull: Cecchetti (1986) mbi çmimet e revistave; Lach dhe Tsiddon (1992) dhe Eden (2001) mbi çmimet e ushqimeve; Kashyap (1995) mbi çmimet e katalogëve; Levy et al. (1997) mbi

çmimet në supermarkete; dhe Genesove (2003) mbi qiratë e apartamenteve. Të dhënat e përdorura në studimin tonë, si dhe në metodologjitë ku është bazuar, lejojnë një analizë më të zgjeruar mbi klasifikimin e shpenzimeve ECOICOP[1] e veçanërisht 12 kategoritë kryesore të tij: ushqime dhe pije joalkoolike; pije alkoolike dhe duhani; veshje dhe këpucë; qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji; mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë; shëndet; transport; komunikim; argëtim dhe kulturë; edukim; hotele, kafene dhe restorante; mallra dhe shërbime të ndryshme.

Analiza fokusohet në periudhën T1 2008-T2 2019 dhe bazohet në llogaritjen e tre treguesve kryesorë: frekuenca, madhësia dhe qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve. Analiza është kryesisht me natyrë deskriptive dhe është bazuar në përqasjen e Erlandsen (2014) dhe Alvares, Hernando (2004). Qëllimet kryesore të studimit janë së pari, të përftohet një matës kuantitativ i nivelit të pakushtëzuar të ngurtësisë së çmimeve dhe së dyti, të kuptuarit më mirë të natyrës kualitative të procesit çmim-përcaktues dhe të modeleve të sjelljes së çmimeve në nivel mikro. Rezultatet janë të organizuara në formën e 4 fakteve të stilizuara.

Gjetjet sugjerojnë se sjellja çmim-përcaktuese është heterogjene në gamën e të mirave, ku në përgjithësi çmimet e shërbimeve janë më të ngurta se ato të mallrave e për rrjedhojë është e vështirë të arrihet një konkluzion i qartë nëse sjellja agregate e çmimeve është e ngurtë në tërësinë e saj. Sjellja e çmimeve është heterogjene, jo vetëm midis kategorive kryesore të ECOICOP, por shfaq heterogjenitet edhe mes sektorëve që ato përmbajnë. Pavarësisht kësaj, në terma të përgjithshëm, rezultatet janë në linjë me përshkrimin e katër karakteristikave të Taylor (1999) mbi procesin e përcaktimit të çmimeve. Së pari, çmimet mbeten konstante për periudha relativisht të gjata në kohë. Së dyti, rezultatet sugjerojnë se çmimet janë të ngurta në mënyrë të moderuar dhe ato ndryshojnë mesatarisht çdo 4 deri në 5 muaj. Së treti, madhësia e ndryshimit të çmimeve, në terma mesatarë, është më e lartë se inflacioni, gjë e cila sugjeron se goditjet idiosinkratike (individuale/unike) janë më të rëndësishme se ato agregate. Së fundi, frekuenca e ndryshimit të çmimeve duket të jetë e varur nga norma mesatare e inflacionit[2]. Rezultatet sugjerojnë gjithashtu se ngurtësia e çmimeve për poshtë nuk ka qenë prezente si dukuri para vitit 2012 dhe ajo është zbutur edhe më tej pas vitit 2012.

Materiali është i strukturuar si më poshtë. Në seksionin e dytë do të përshkruhet sjellja dhe performanca e inflacionit gjatë periudhës në shqyrtim, gjë e cila bën të mundur ilustrimin e sjelljes së çmimeve dhe trendeve kryesore. Më tej, në seksionin e tretë dhe të katërt do të prezantohet metodologjia, të dhënat e përdorura dhe rezultatet. Së fundmi, në seksionin 5 jepen përfundimet e analizës.

[1] *European Classification of Individual Consumption according to Purpose.*
[2] *Kjo hipotezë nuk është testuar me metoda empirike.*

2. ECURIA E INFLACIONIT 2008-2019

Periudha e marrë në shqyrtim për analizën është T1-2008 deri T2-2019. Gjatë kësaj periudhe, ecuria e inflacionit mund të ndahet në dy periudha kryesore. Periudha T1-2008 deri në T2-2011 e cila karakterizohet nga një prirje inflacioniste e çmimeve, por brenda objektivit të Bankës Qendrore dhe periudha e dytë T3-2011 deri në T2-2019, e cila karakterizohet nga një prirje në kahun rënës të inflacionit[3].

Gjatë periudhës së parë, kriza financiare dhe ekonomike globale pati një impakt të rëndësishëm në ekonominë shqiptare edhe pse jo të menjëhershëm. Gjatë kësaj periudhe, u vu re në bazë të anketave të zhvilluara nga ana e Bankës së Shqipërisë, një shtim i pasigurisë së agjentëve ekonomikë për një transmetim të shpejtë dhe të fortë të krizës botërore në ekonominë shqiptare (Banka e Shqipërisë, Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Konsumatorëve T1 2008-T4 2009). Prodhimi agregat pësoi goditje si pasojë e tkurrjes së investimeve private dhe publike, si dhe ngadalësimit të ndjeshëm të konsumit privat, e ndikuar nga pasiguria e shtuar e agjentëve ekonomikë. Zhvillimet në kreditimin e sektorit privat gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009, tregojnë për një ngadalësim të rritjes së kredisë, e cila ka qenë prezente përgjatë gjithë periudhës. Megjithatë, inflacioni në periudhën T1-2008 deri në T3-2011, qëndroi brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Vlerat e inflacionit u kushtëzuan në një masë të madhe nga faktorët e ofertës. Veçanërisht në këtë periudhë ka pasur kontribut të rëndësishëm kriza e energjetikës dhe rritja e çmimit të energjisë. Përveç rritjes së çmimit të energjisë elektrike, oferta e kufizuar e prodhimit bujqësor vendas dhe tendenca rritëse e çmimeve të lëndëve të para në tregun botëror, në prani të efektit të nënçmimit të monedhës vendase, kanë ushtruar presione në kahun rritës mbi inflacionin. Këta faktorë kanë rritur pasigurinë e agjentëve ekonomikë si dhe primet e rrezikut në tregjet financiare, ndërkohë që inflacioni i lartë i importuar nga tregjet botërore ka dhënë ndikim frenues në kërkesën e brendshme dhe ka rritur pritjet inflacioniste në vend. Gjithsesi, kontributi i ulët i mëvonshëm i çmimeve të administruara, si dhe efektet në shuarje të goditjeve të ofertës të evidentuara gjatë 2010-ës dhe fillimit të vitit 2011 sollën që inflacioni të ndikohet kryesisht nga hendeku negativ i prodhimit i udhëhequr nga ulja e investimeve dhe e konsumit privat në ekonomi. Banka e Shqipërisë paralajmëroi për një balancë rreziqesh, të cilat do ta zhvendosnin inflacionin në një kah rënës në afatin e mesëm, ashtu siç u materializua në periudhën pasuese.

[3] *Në vitin 2015 Banka e Shqipërisë e ka ndryshuar vlerën target të inflacionit bazuar në strategjinë afatmesme të saj nga 3% me fashë +-1%, në një inflacion 3%.*

Grafiku 2.1 Ecuria e inflacionit 2008-2019



Burimi: Raportet tremujore të politikës monetare 2008-2019

Përsa i përket periudhës pasardhëse, inflacioni i ulët pas T3-2011 deri në fillim të vitit 2016 u udhëhoq fort nga hendeku negativ i prodhimit, si dhe nga kredidhënia më e ulët e sektorit bankar. Në kahun e ofertës, ngadalësimi i çmimeve të mallrave kryesore në tregjet botërore dhe i inflacionit në vendet partnere, kombinuar me një ecuri të qëndrueshme të kursit të këmbimit, u përcoll në inflacionin e importuar në ekonominë shqiptare. Njëkohësisht, kontributi i çmimeve të administruara ka qenë më i ulët, pothuajse i papërfillshëm në krahasim me periudhën e parë. Gjatë kësaj periudhe rritja e aktivitetit ekonomik në vend është nxitur kryesisht nga kërkesa e huaj, ndërkohë që aktorët e ekonomisë vendase kanë shfaqur fillimisht një moment tkurrjeje dhe më pas qetësie. Duke filluar nga T1-2016 është vëzhguar një trajektore pozitive rritjeje në prodhim e nxitur si nga gjallërimi i konsumit, po ashtu edhe i investimeve. Ndërkohë që periudha 2017-2018 është karakterizuar dhe nga një forcim i shpejtë i lekut duke cenuar objektivin e stabilitetit të çmimeve. Gjatë 2018-ës, Banka e Shqipërisë mori masa për ndërhyrjen në tregun valutor, gjë e cila solli frenimin e presioneve në treguesin e inflacionit (Banka e Shqipërisë, 2018). Gjatë 2019-ës, inflacioni ka shfaqur një sjellje jo të luhatshme, me një vlerë mesatare të inflacionit vjetor 1.7%. Banka e Shqipërisë mbajti një politikë monetare stimuluese në treg.

Në terma të komponentëve të shportës së konsumit, çmimet e ushqimeve dhe kryesisht ato të ushqimeve të papërpunuara janë ato që kanë udhëhequr kryesisht presionet inflacioniste gjatë periudhës në shqyrtim. Çmimet e administruara kanë pasur një kontribut të rëndësishëm në normën e inflacionit deri në vitin 2010, ndërkohë që pas kësaj periudhe kontributi ka qenë më i ulët. Produktet jo-ushqimore, po ashtu si çmimet e administruara kanë pasur një kontribut më të ulët në treguesin e inflacionit total. Ndërkohë që gjatë periudhës 2018-2019, vihet re një rritje e kontributit i cili është i udhëhequr nga rritja e çmimit të karburantit dhe qirave të banimit.

3. TË DHËNAT DHE METODOLOGJIA

Ky material ka për qëllim të analizojë sjelljen e çmimeve në Shqipëri gjatë periudhës 2008-2019 bazuar në llogaritjen e tre treguesve kryesorë: frekuenca, sasia dhe qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve. Metodologjia e përdorur është një kombinim i dy qasjeve të Erlandsen (2014) dhe Alvares, Hernando (2004) dhe është e një natyre deskriptive, ku rezultatet do të prezantohen në formën e katër fakteve të stilizuara.

Materiali përdor të dhënat e dezagreguara të IÇK-së (indeksi i çmimeve të konsumit) dhe përllogaritje statistikore për të dhënë evidenca rreth ngurtësisë së çmimeve, si dhe heterogjenitetit të sjelljes midis grupeve të ndryshme të shportës së konsumit. Informacioni mbulon mbi 13,000 çmime individuale dhe 135 komponentë të shportës së konsumit për periudhën T1 2008-T2 2019. Shporta e përdorur për analizën përfaqëson 85% të shportës së konsumit final të familjeve dhe është e bazuar në klasifikimin ECOICOP. Të dhënat e përdorura për analizën janë lehtësisht të grupueshme dhe të agregueshme.

Periodiciteti me të cilin firmat ndryshojnë çmimet paraqet një element kyç për të karakterizuar sjelljen çmim-përcaktuese të tyre. Për të matur këtë periodicitet përdorim dy tregues të ndryshëm: frekuenca e ndryshimeve të çmimeve (F) dhe qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve (T^F) të cilët janë ngushtësisht të lidhur me njëri-tjetrin.

FREKUENCA E NDRYSHIMIT TË ÇMIMEVE

Frekuenca e ndryshimit të çmimeve këtu përkufizohet si raporti i ndryshimeve (mujore të vjetorizuara) jo-zero të çmimeve ndaj observimeve totale. Bazuar në Erlandsen (2014):

$$F_j = \frac{\sum_{i=1}^{n_j} \sum_{t=2}^{\tau} NUM_{ijt}}{\sum_{i=1}^{n_j} \sum_{t=2}^{\tau} DEN_{ijt}}$$

Ku NUM është "*dummy*" që tregon nëse çmimi i produktit i ka ndryshuar në kohën t, DEN është "*dummy*" që tregon nëse produkti që është vëzhguar në kohën t është vëzhguar edhe në kohën t-1, n_j është numri i produkteve të vëzhguara në kategorinë j dhe është periudha kohore për të cilën është raportuar mbi çmimet e produktit j.

Treguesi i frekuencës do të raportohet edhe si tregues më vete, por qëllimi primar është përllogaritja e indekseve të çmimeve të ngurta dhe atyre fleksibël. Për ndërtimin e indekseve do të ndiqen dy hapa bazuar mbi përqasjen e Erlandsen (2014):

(1) Hapi i parë konsiston në përllogaritjen e vlerës së frekuencës për secilën nënkategori të përbërësve të shportës së konsumit. Më tej, bazuar mbi vlerën mediane të frekuencës, produktet janë klasifikuar në dy grupe, në

ata që karakterizohen nga çmime të ngurta ose në ata që karakterizohen nga çmime fleksibël.

(2) Hapi i dytë konsiston në përllogaritjen e indekseve agregate të çmimeve fleksibël dhe të ngurta duke përdorur peshat dhe indekset përkatëse të IÇK-së. Si për treguesin e frekuencës, edhe për dy treguesit e tjerë do të ndjekim të njëjtin protokoll peshimi për të raportuar një vlerë agregate të treguesve. Duke qenë se të dhënat per të cilat disponohet informacion në lidhje me IÇK janë ato në 39 nënkategori, fillimisht përllogariten treguesit e frekuencës duke përdorur observimet e të mirave që ndodhen në çdo nënkategori bazuar mbi klasifikimin ECOICOP[4]. Më tej, treguesi i frekuencës agregohet duke mesatarizuar vlerat e secilës nënkategori dhe duke përdorur IÇK-të përkatëse si pesha.

QËNDRUESHMËRIA E AXHUSTIMIT TË ÇMIMEVE

Siç diskutohet në Alvares dhe Fernando (2004), duke supozuar stacionaritet dhe homogjenitet të sjelljes së ndryshimit të çmimeve në dimensionin "*cross-section*", e anasjella e frekuencës F konvergjon në një kampion të madh, në një vlerë mesatare të T^F. Kjo veti asimptotike mund të përdoret për të vlerësuar treguesit mesatarë F dhe T^F.

Pra për sa më sipër:

$$T_j^F = \frac{1}{F_j}$$

Ekuacioni i mësipërm është intuitiv: nëse çmimet e 31% të të mirave ndryshojnë çdo muaj, ath T^F mesatare është 1 e pjesëtuar me 0.31, ose 3.2 muaj. Nëse supozojmë se çmimet mund të ndryshojnë në çdo moment, pra probabiliteti që çmimi të ndryshojë është i njëjtë çdo ditë të muajit, mesatarja e treguesit të qëndrueshmërisë së axhustimit të çmimeve mund të shprehet me formulën më poshtë:

$$T_j^F = -\frac{1}{\ln(1 - F_j)}$$

Por, në anën tjetër, formulat e mësipërme qëndrojnë vetëm nëse të gjitha çmimet shfaqin të njëjtën pritshmëri ndërkohë që në realitet çmimet nuk kanë të njëjtën frekuencë ndryshimi. Në të vërtetë, disa produkte shfaqin një tregues të frekuencës shumë të ulët që do të thotë se çmimet e tyre ndryshojnë shumë rrallë e për rrjedhojë kjo mund të influencojë në treguesin mesatar të qëndrueshmërisë së axhustimit të çmimeve. Për këtë arsye, peshimi, sipas metodës së përshkruar më sipër, mbetet një hap shumë i rëndësishëm për t'u ndjekur në ndërtimin e treguesit agregat të qëndrueshmërisë.

[4] *Shiko tabelën A1 në shtojcë për kategoritë dhe nënkategoritë kryesore të ECOICOP.*

MADHËSIA E AXHUSTIMIT TË ÇMIMEVE

Përveç treguesve të frekuencës së axhustimit të çmimeve dhe qëndrueshmërisë së axhustimit të çmimeve, gjithashtu llogaritet një tregues i madhësisë së ndryshimeve të çmimeve (ΔP në terma mujore të vjetorizuara), që matet si diferencë në logaritëm. Supozimi që bëhet është që çmimet ndryshojnë vetëm një herë brenda një muaji të caktuar (ose brenda një tremujori për ato produkte, çmimet e të cilave mblidhen në baza tremujore). Ky supozim duket se i përafrohet realitetit me përjashtim të pak produkteve ushqimore të papërpunuara për të cilat qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve është zakonisht më e shkurtër se një muaj. E njëjta përqasje për peshimin e treguesve agregatë është e vlefshme edhe për këtë tregues.

4. REZULTATET

Më poshtë janë paraqitur gjetjet kryesore të analizës. Paraqitja është bërë në formën e katër fakteve të stilizuara të cilat japin informacion për karakteristikat e sjelljes çmim-përcaktuese.

FAKTI 1: Çmimet e konsumit janë të ngurta në mënyrë të moderuar

Frekuenca mediane mujore e ndryshimeve të çmimeve është 21.4% (treguesi i frekuencës merr vlera që variojnë midis 0 dhe 1, ku 0 nënkupton se çmimet nuk ndryshojnë asnjëherë, ndërsa vlera 1 nënkupton se çmimet ndryshojnë çdo muaj), dhe çmimet ndryshojnë mesatarisht një herë në çdo 4 ose 5 muaj. Çmimet fleksibël përbëjnë 60% të çmimeve totale (mbi medianën 0.214/21.4%) dhe çmimet e ngurta përbëjnë 40% të çmimeve totale (nën medianën 0.214/21.4%)[5]. Çmimet e ushqimeve të papërpunuara janë ato të cilat shfaqin frekuencën më të lartë të ndryshimit, duke ndryshuar çdo 1.7 muaj ndërkohë që çmimet e ushqimeve të papërpunuara ndryshojnë më rrallë, çdo 5 muaj.

Tabela 4.1. Frekuenca dhe qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve

	Totali	Ushqimet e përpunuara	Ushqimet e papërpunuara	Shërbimet	Mallra konsumi jo-ushqimorë
Frekuenca e ndryshimit të çmimeve	21.4	19.9	56.2	6.2	15.2
Frekuenca e çmimeve rritëse	11.2	11.6	29.1	4.1	5.1
Frekuenca e çmimeve rënëse	10.2	8.3	27.1	2.1	4.9
Qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve (muaj)	4.671	5.022	1.768	16.121	6.569
Qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve rritëse (muaj)	8.918	8.618	3.321	24.311	19.605
Qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve rënëse (muaj)	9.802	12.01	3.632	47.602	20.408

Burimi: Indeksi i çmimeve të konsumit 2008-2019 , llogaritjet e autorit.

Në anën tjetër, edhe pse sjellja e çmimeve mes të mirave shfaq një sjellje pothuajse simetrike në raportin 1:1 mes çmimeve rritëse dhe rënëse, kjo sjellje nuk vihet re për çmimet e shërbimeve. Sipas tabelës 4.1 më sipër, çmimet e shërbimeve ndryshojnë mesatarisht çdo 16 muaj në një raport 1:2 (24

[5] *Shiko Grafikun 4.1 në faqen 22 për më shumë informacion.*

muaj përkundrejt 47 muaj) të çmimeve rritëse dhe çmimeve rënëse. Alvarez dhe Hernando (2005) argumentojnë se diferencat në strukturën e kostos midis dy sektorëve janë ato të cilat mund të shpjegojnë prezencën ose jo të simetrisë. Kostot e punës janë inputi më pak i luhatshëm krahasuar me inputet e tjera e për rrjedhojë kjo prek dhe çmimin final të shërbimeve. Ajo çka është më e rëndësishme është se kjo ngurtësi në sektorin e shërbimeve mund të përkthehet në një nivel më të lartë të persistencës së inflacionit në nivel agregat (Lunnemann dhe Matha, 2005b). Sigurisht, kjo është e varur dhe nga mënyra sesi rregullohet tregu i punës gjithashtu dhe me shkallën e punësimit formal vs atij joformal në ekonomi.

Duke iu referuar tabelës 4.2 më poshtë, frekuenca e çmimeve rënëse është pak më e shpeshtë pas vitit 2012, që përkon dhe me periudhën kur inflacioni ka pasur presione në kahun rënës. Në këtë kontekst, duke qenë se INSTAT i merr në konsideratë uljet e sezonit dhe promocionet, kjo vlerë mund të jetë pak më e ulët nëse nuk i marrim këto çmime në konsideratë.

Tabela 4.2. Frekuenca dhe qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve para dhe pas T1-2012

	Frekuenca e ndryshimit të çmimeve	Qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve	Frekuenca e çmimeve rritëse	Qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve rritëse	Frekuenca e çmimeve rënëse	Qëndrueshmëria e axhustimit të çmimeve rënëse
Totali	0.214	4.671	0.112	8.918	0.102	9.802
Totali para T1-2012	0.218	4.113	0.129	7.748	0.089	4.117
Totali pas T1-2012	0.205	5.902	0.102	9.309	0.112	3.181

Burimi: Indeksi i çmimeve të konsumit 2008-2019 , llogaritjet e autorit.

Studime të ngjashme gjejnë një spektër të gjerë të vlerave të frekuencës së përllogaritur. Në Eurozonë ndryshimet mes vendeve variojnë nga 10% në Itali deri në 23% në Luksemburg. Po ashtu, në vendet e Eurozonës nuk është dokumentuar një ngurtësi nominale e çmimeve për poshtë në terma të çmimeve mesatare ose mediane (Dhyme, Alvarez et al, 2006).

Tabela 4.3. Frekuenca e ndryshimit të çmimeve në vendet e Eurozonës

	Ushqimet e papërpunuara	Ushqimet e përpunuara	Energjia (produktet e naftës)	Të mira industrial jo-energji	Shërbimet	Peshat e vendit b	Peshat e Eurozonës c
Austri	37.5	15.5	72.3	8.4	7.1	15.4	17.1
Belgjikë	31.5	19.1	81.6	5.9	3.0	17.6	15.6
Gjermani	25.2	8.9	91.4	5.4	4.3	13.5	15.0
Spanjë [d]	50.9	17.7	–	6.1	4.6	13.3	11.5
Finlandë	52.7	12.8	89.3	18.1	11.6	20.3	–
Francë	24.7	20.3	76.9	18.0	7.4	20.9	20.4
Itali	19.3	9.4	61.6	5.8	4.6	10.0	12.0
Luksemburg	54.6	10.5	73.9	14.5	4.8	23.0	19.2
Holandë	30.8	17.3	72.6	14.2	7.9	16.2	19.0
Portugali	55.3	24.5	15.9	14.3	13.6	21.1	18.7
Eurozonë	28.3	13.7	78.0	9.2	5.6	15.1	15.8

Burimi: Dhyne, Alvarez et al. (2006)

a Shifrat e paraqitura në këtë tabelë llogariten në bazë të kampionit prej 50 produktesh, me një përjashtim për rastin e Finlandës, ku shifrat përllogariten nga Indeksi i plotë i Çmimeve të Konsumatorit. Shifrat e eurozonës nuk përfshijnë Greqinë dhe Irlandën.
b Totali është llogaritur duke përdorur peshat specifike të vendit për çdo produkt.
c Totali është llogaritur duke përdorur peshat e eurozonës për secilin nën-indeks. Nuk jepen shifra për Finlandën për shkak të problemit të krahasueshmërisë së kampionit të produkteve të përdorura.
d Në bazën e të dhënave të Spanjës nuk përfshihen produktet e energjisë, të cilat zhvendosin poshtë frekuencën e totalit.

Janë disa faktorë për të cilët literatura pajtohet se sjellin heterogjenitet në treguesin e frekuencës midis vendeve. Një faktor shumë i rëndësishëm është modeli i konsumit i cili ndryshon nga një vend në tjetrin e për rrjedhojë ka impakt në vlerat e përllogaritura të frekuencës. Në vendet ku ushqimet dominojnë shportën e konsumit, vlerat mediane të frekuencës janë më të larta. Një element tjetër i rëndësishëm është dhe forma e organizimit të tregut: vendet ku tregjet janë të organizuara me dyqane të vogla përkundrejt vendeve që janë të organizuara me supermarkete, hipermarkete ose dyqane të mëdha. Një dyqan i madh ka më shumë probabilitet që t'i ndryshojë çmimet më shpesh sesa një dyqan i vogël e për rrjedhojë dhe frekuenca e ndryshimit do të jetë më e lartë. Në anën tjetër, mënyra sesi rregullohen çmimet është shumë e rëndësishme. Nëse çmimi i energjisë, është i kontrolluar ose rregulluar në mënyrë ekskluzive nga institucionet shtetërore, pra ai nuk ndryshon nga tregu në mënyrë të lirë, kjo do të ketë impakt në treguesin e frekuencës mediane. Gjithashtu, impakt në këtë kontekst kanë dhe rregulloret e tjera, si për shembull ato për uljet në dyqane, barrierat në hyrjen dhe daljen e tregut, por këta faktorë janë të vështirë për t'u kuantifikuar. Në këtë kuadër, një element i rëndësishëm është dhe mënyra se si agjencitë e statistikave zyrtare mbledhin të dhënat mbi çmimet e shportës së konsumit dhe veçanërisht mënyra se si trajtojnë dhe raportojnë promocionet dhe uljet e çmimeve në fund të sezonit.

FAKTI 2: Sjellja e çmimeve shfaq një sjellje heterogjene

Në grafikun 4.1 më poshtë është paraqitur shpërndarja e vlerave të treguesit të frekuencës të sektorëve kryesorë të ECOICOP, si dhe vlera e medianës për krahasim. Në grafikun e parë paraqiten vlerat për totalin, ndërsa në grafikun e dytë dhe të tretë paraqitet frekuenca për çmimet rritëse dhe çmimet rënëse respektivisht.

Siç u përmend më sipër, fleksibiliteti i çmimeve është më i lartë për çmimet e të mirave dhe më i ulët për çmimet e shërbimeve. Heterogjeni është prezent midis kategorive kryesore të ECOICOP siç mund të shihet nga grafiku, por edhe midis të mirave të përfshira brenda këtyre kategorive duke sugjeruar se sjellja e çmimeve nuk është homogjene. Ajo që është vërejtur në studime të

ngjashme është se efekti i heterogjenitetit mes vendeve shpjegohet në masën 90% nga efekti i heterogjenitetit mes sektorëve dhe të mirave të ndryshme.

Grafiku 4.1 Frekuenca e ndryshimit të çmimeve (total, rritëse, rënëse)



Burimi: Indeksi i çmimeve të konsumit 2008-2019 , llogaritjet e autorit.

Në grafikun 4.2 më poshtë është paraqitur gjithashtu frekuenca e agreguar e kategorive kryesore të ECOICOP dhe mediana e përllogaritur mbi vlerat agregate.

Grafiku 4.2 Frekuenca e ndryshimit të çmimeve sipas kategorive kryesore të ECOICOP



Burimi: Indeksi i çmimeve të konsumit 2008-2019 , llogaritjet e autorit.

Kategoria e cila shfaq çmimet më fleksibël është kategoria e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike, kryesisht duke reflektuar sjelljen e çmimeve të ushqimeve të papërpunuara. Kategoritë e ECOICOP që gjithashtu në terma agregate shfaqin një sjellje fleksibël të çmimeve janë: mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë, veshje dhe këpucë, qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji, transport si dhe hotele, kafene dhe restorante.

Në kahun tjetër, kategoritë e ECOICOP të cilat shfaqin në terma agregate një sjellje të ngurtë të çmimeve janë: edukimi, komunikimi, argëtim dhe kulturë, shërbimet e ndryshme dhe shëndeti. Duke marrë parasysh se 12 kategoritë e ECOICOP përbëhen nga një shumëllojshmëri të mirash dhe shërbimesh, sjellja agregate mund të udhëhiqet nga sjellja e disa sektorëve në këtë nivel të cilat janë shumë fleksibël ose shumë të ngurta pavarësisht metodave të peshimit. Një shembull i tillë është kategoria e transportit e cila në fakt ndikohet nga çmimi i biletave të fluturimeve dhe trageteve dhe karburanti të cilat janë shumë fleksibël, ndërkohë që çmimet e transportit publik, taksive dhe pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të motomjeteve janë më të ngurta. Për këtë arsye, analiza në nivel nën-kategorie përmban një gabim më të ulët në interpretim.

FAKTI 3: Inflacioni i çmimeve fleksibël ka një korrelacion të fortë me inflacionin total

Në grafikun 4.3 më poshtë është paraqitur grafiku i inflacionit total i dezagreguar sipas vlerave të inflacionit të çmimeve fleksibël dhe atyre të ngurta. Inflacioni i çmimeve fleksibël është ai që kryesisht ka udhëhequr sjelljen e inflacionit ndër vite. Inflacioni i çmimeve të ngurta përgjithësisht ka një trajektore të pavarur nga inflacioni total dhe është më i qëndrueshëm, pra nuk shfaq luhatje të mëdha në kohë, gjë e cila është e pritshme duke qenë se çmimet e ngurta ndryshojnë më rrallë.
